

INTERVISTË ME SHEFQET JASHARIN, ANËTARIN E KOMITETIT QENDROR TË LËVIZJES NACIONAL ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS DHE VISEVE SHQIPTARE NËN JUGOSLLAVI (LNÇKVSHJ)



SHEFQET JASHARI

Intervistoi: **Shefki Oseku.**

DDRITA: Ju lutem që në fillim të na tregoni se ku keni lindur, ku e keni kryer shkollën fillore, të mesmen e shkollën e lartë?

Sh. Jashari: U lindi në fshatin Strofc, komuna e Vushtrrisë, më 15.05.1944. Klasën e parë e kam kryer në një odë të një fshatari në fshatin Bequk, të dytën në xhaminë e fshatit të Bequkut. Klasën e tretë dhe të katërtën në shkollën fillore të Zhilivodës. Të pestën të gjashtën dhe të shtatën në shkollën fillore të Prilluzhës, kurse klasën e tetë në Prishtinë. Shkollën e Mesme Bujqësore e kam kryer në Prishtinë, më 1964. Shkollën e Lartë Pedagogjike, Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe e kam kryer më 1970, në Prishtinë.

DRITA: A mund të na flisni për fëmijërinë Tuaj, edukatën patriotike të marrur në atë periudhë.

Sh. Jashari: Si fëmijë e kam përjetuar skamjen e bukës në vitet e '50-ta, akcionin famëkeq të armëve, shpërnguljet e mëdha për Turqi, pas okupimit të tretë të Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare nga serbosllavët. Fshati i vendlindjes sime, Strofc, me 16 fshatra tjera, e përbëjnë një tërësi territoriale strategjike që quhet Artakoll dhe i përfshinë fshatrat që gjenden në mes Grykës së Novolanit dhe asaj të Mjekiqëve dhe rrjedhës së lumit Sitnicë e kurrizit të malit Çiqavicë. Artakolli ka qenë gjithmonë mbështetje e fortë e të gjitha kryengritjeve shqi-

ptare kundër robërisë turke dhe sllave. Si nxënës i shkollës fillore, nëpërmjet babës, mixhës dhe musafirëve që bisedonin në odë, kam mësuar për luftërat e çetave të Azem Bejtës dhe Kryengritjen e Drenicës, të udhëhequr nga atdhetari Shaban Polluzha si dhe për Luftën Mbrojtëse të fshatrave Bivolak, Strofc, Zhilivodë, Gllavotinë dhe Bequk, të ndihmuara edhe nga atdhetarët e fshatrave tjerë të Artakollit dhe të Drenicës që e kishin pas thyer sulmin e çetave çetnike serbe dhe të Ushtrisë së Rregullt të Mbretërisë SKS-ës. Babai dhe xhaxhai im kanë qenë pjesëmarrës të Kryengritjes së Drenicës dhe të Luftës Mbrojtëse të vitit 1941, prandaj si familje kemi qenë nën vëzhgimin e klyshëve të vegjël të fshatit. Bastisjet e shtëpisë për të gjetur armë, marrja e miellit nga magjësja, marrja e drithit nga hambari, marrja e bagëtive nga ahuri, si "tepricë", duke e lënë familjen 20 anëtarshë pa asnjë kilo miellë dhe pa drithë, si dhe përjetimi me shpirt i maltretimeve të bashkëfshatarëve të mi gjatë akcionit të armëve, më 1956, kanë ndikuar shumë në formimin tim patriotik gjatë asaj moshe. Unë i kam parë me sytë e mi fshatarët e rreshtuar në oborr të stacionit të policisë, të zbatuar dhe të zdeshur, në borë, duke pasur në trup vetëm tëlina (brekët) e gjata. Këto skena trishtuese që i kam përjetuar si fëmijë dhe si nxënës i shkollës fillore, ma patën ngulitur në tru dhe në zemër urrejtjen kundër pushtuesve serbë dhe robërisë në përgjithësi. Emri i mësuesit të parë nuk më kujtohet, por fjalët dhe përkdheljet e tija edhe sot i kam të freskta në kujtesën time. Mësuesi im i dytë ka qenë Haki Gushani, nga Vushtrria. Ka qenë pedagog dhe njeri i mirë.

DRITA: A mund të na flisni se kur ia filluat veprimtarisë së organizuar patriotike, sa vjeç ishe dhe cili qe momenti vendimtar që iu nxitu për t'iu qasur kësaj veprimtarie?

Sh. Jashari: Më parë kisha për të cekur ca faktorë që më pregaditën psikikisht dhe shpirtërisht për të marrë pjesë në veprimtarinë e organizuar kombëtare. Në pyetjen e parë i ceka faktorë që ndikuan në formimin dhe edukimin tim në bazë kombëtare. Tani po i ceku edhe ca faktorë tjerë: 1. Njohja ime me Avdyl Lahun, më 1960 si nxënës i Shkollës së Mesme Bujqësore në Prishtinë; 2. Njohja nëpërmjet Avdyl Lahut me Adem Demaçin, Fazli Grajqefcin, Zeqir Gërvallen, Sabit Rotkocerin etj.; 3. Më 1961 u burgosën dhe u dënuan: Kadri Halimi, Ramadan Halimi, Ali Aliu dhe katër fshatarë të mij. Këta janë: Zenel Hajrizi, Zeqir Hajrizi, Selman Hasani dhe Miftar Mustafa. I pata përcjellur disa seanca gjyqësore dhe shumë gjëra pata mësuar nga veprimtaria e tyre patriotike; 4. Shtypja kombëtare dhe varfëria e madhe që shihej çdo ditë në rrugët e Prishtinës e gjetiu; 5. Dëgjimi rregullisht i Radio Tiranës, veçmas stacionet e gjuhëve të huaja. Poashtu e kam përcjellur edhe Radio Moskën, Radio Këlnin, dhe Radio Pekinin; 6. Leximi i Rilindjes, Jetës së Re, Përparimit dhe romaneve të pakta që i kishim atëherë. Këto, si të thuash, e përbënin bazamentin tim patriotik të asoko-hshëm. Por, organizimi im i mirëfilltë patriotik filloi në verën e vitit 1963, kur Avdyl Lahu më propozoi për t'u bërë anëtar i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve. Pasi pranova të bëhem anëtar dhe e dhashë betimin, Avdyli m'i caktoi detyrat. E njëra ndër to ishte formimi i celulave të reja të LRBSH-ës. Brenda një kohe të shkurtër dy shokë klase R.Q. dhe H.H një shok imi nga Kolovica N.K., një fshatar imi nga Strofci N.H. si dhe një shok i babës tim nga Brezhnica S.M. pranuan të bëhën anëtarë të Organizatës në fjalë. Anëtarësinë e kanë paguar shumica prej tyre. Detyrën për t'u armatosur (siç parashihej me Programin e LRBSH-ës) nuk pata mundësi ta kryej unë dhe as dy shokët e mi të klasës. Fshatari nga Brezhnica u zotua se do t'ia falë Organizatës pesëmijë fishekë pushkë dhe do ta bëj një strehimore për t'i fshehur armët në malin e tij, që e kishte

shtëpisë. Më vonë unë dhe Avdyli e patëm organizuar takimin në mes S.M. nga Brezhnica dhe Adem Demaçit. Në fillim të muajit qershor të vitit 1964 u hap lajmi, gojë pas goje, për burgosje të mëdha që i bëri UDB-a në tërë Kosovën. Mësova për burgosjen e Adem Demaçit, Avdyl Lahut, Ahmet Haxhisë dhe për shumë emra tjerë që unë s'i njihja. Shkova nga fshati im në Prishtinë për të mësuar diçka më tepër për burgosjet, dhe për të marrë lidhjet me shokët që nuk kishin rënë nëpër burgje. I njihja ca shokë të Avdylit, me të cilët më parë i patëm lexuar së bashku disa pjesë të Lahutës së Malsisë. U takova me Hilmi Rakovicën. Ai ishte i mendimit që t'i ngrisim flamujt kombëtarë, kurse unë isha i bindur se ne duhet t'ia bëjmë me dije botës për burgosjet e mëdha, ndaj ne do të duhej të bëjmë akcione më të mëdha. Meqenëse dija ta përdori eksplozivin, pasi që katër vite me radhë kisha punuar gjatë pushimeve verore në minierat e gurëve në Gërmi dhe kisha mundësi ta siguroj një sasi të mjaftueshme të eksplozivit, i propozova Hilmiut t'i minojmë urat hekurudhore dhe t'i ngrisim në ajër. Nuk u pajtuam me njëri - tjetrin dhe u ndamë, pa u marrur vesh për asgjë. Po atë ditë u takova me një shok timin, që xhaxhai i tij punonte në një magazinë, ku ruhej eksploziv për thyerjen e gurëve. Ai më premtoi se do t'i siguroi tetë kilo eksploziv. Shokut nuk i tregova arsyen e vërtetë pse e kërkoja eksplozivin dhe u muarëm vesh sesa të holla duhet sjellur kur ta marrë eksplozivin. Vendtakimi u caktua në Kodrën e Dragodanit, ku çdo vit më shtatë korrik organizohej motokrosi në nivel ndërkombëtar. Të nesërmën u takova edhe me një anëtar të Organizatës, L.S. nga Dobërdoli i Llapit, që bënte pjesë në një celulë të Avdyl Lahut. Ai pranoi të kryej një akcion në Llap. Takimi ku duhej ta marrë eksplozivin mbet të bëhet me shtatë korrik, në Dragodan. Disa ditë pasi u ktheva në Strofci, të unë erdhi fshatari nga Brezhnica S.M., duke më propozuar të dalim në mal, për t'ia filluar kryengritjes së armatosur. E binda se ne nuk mund ta marrim një përgjegjësi kaq të madhe, dhe i propozova planin tim. Nuk më dha përgjegje, por as nuk e mori Statutin që ma pat dhënë Avdyl Lahu. (Avdyli para se të burgoset më pat thënë që Statutin e LRBSH-ës t'ia ipja S.M. nga Brezhnica.

Poashtu më pat udhëzuar që Statutin ta fusja në një shishe qelqi dhe ta propozja dikund nën dhe, gjë që e pata bërë). Pas dy tri ditësh erdhën tek unë edhe dy shokë të Avdyllit, që ai i pat organizuar: D.D. ishte mësues, i cili më parë i pat kryer dy klasë të SHMB, dhe tjetri F.I. edhe ky e pat kryer me mua SHMB. Pasi treguan gadishmëri për ta kryer akcionin që ua propozova, u marrëm vesh që ata t'i sigurojnë gjysmën e të hollave për ta blerë eksplozivin. Ata pranuan që ta shkatrojnë një urë në drejtim Fushë-Kosovë-Pejë. Unë tashmë isha përcaktuar për ta minuar Urën e Trenit mbi Sitnicë. Shoku im N.K. nga Makofci me të cilin kisha punuar së bashku në minierën të gurëve pranoi, që me njerëzit e tij t'i shkatërrojë magazinat e ushtrisë afër Prishtinës, në Llukare. Më burgosën një ditë para se ta marrë eksplozivin dhe t'ua shpërndajë shokëve për t'i kryer akcionet. Kjo ndodhi pikërisht më dt. 06. 07.1964. Për të më burgosur lehtë, UDB-ës i ndihmoi shumë Halil Haliti nga fshati Beqok, spiuni me damkë i komunës së Vushtrisë. Një kohë ka punuar në bibliotekën e Prilluzhës, pa e kryer as shkollën fillore, më vonë, për shërbimet që ia bëri UDB-ës e bënë njëfarë shefi të një sektori në komunën e Vushtrisë. Ky njeri, një ditë para se të burgosem, pat ardhur tek unë dhe më pat pyetur se çka do të bëj nesër. Unë nuk e njihja atëherë si spiun dhe i tregova të se do të shkojë në Prilluzhë për të blerë ca gjëra ushqimore. Ai të nesërmen tërë kohën më ka përcjellur nëpër Prilluzhë, dhe kur kam hyrë në një ëmbëltore për të pirë një pije freskuese, ai iu ka treguar udbashëve se ku gjendem. Kur kam dalur nga ëmbëltorja, kishin qenë duke më pritur dy udbashë jashtë derës së ëmbëltorës. Ata m'i kanë lidhur përnjëherë dy duart dhe më kanë mbyllur në stacion të policisë Pastaj, më dërguan në SPB të Mitrovicës. Aty më mbajtën disa orë. Për habinë time, ata e kishin ditur në detale planin tim, e nga unë kërkonin njerëzit që është dashur t'i kryejnë akcionet dhe veçmas personin që ka pasur për detyrë të ma sjellë eksplozivin. Pas disa orësh më përcjellën në UDB-ën e Prishtinës. Udbashët i përdorën të gjitha metodat « me të mirë » dhe « me të keq » për t'i vërtetuar gjërat që ata i dinin saktësisht dhe gjërat që i dinin me hame-

ndje. Nuk pranova asgjë « as me të mirë » dhe « as me të keq ». Pra, nuk pranova as atëherë kur UDB-a i përdorte metodat klasike të maltretimit, por as atëherë, kur UDB-a e përdorte elektroskokun. Deri në fund nuk pranova se dikujt i kam dhënë për detyrë që t'i minojë urat.

DRITA: A ju kujtohen emrat e hetuesve dhe a ka mundësi të na i përshkruani me pak fjalë sjelljet e tyre?

S.Jashari: Nuk ua di emrat të gjithëve, por do të më mbesin të paharruara fytyrat e Ibër Haskut, Çedo Topallovit dhe njëfarë Sllavkut. Pas mospjekjes së udbashëve për të zbuluar në tërësi planin për minimin e urave hekurudhore, një ditë u mbush qelia ime me udbashë. Me ta kishte qenë vetë kryeudbashi i Kosovës, Çeda Topallovit. Pasi më shajti dhe m'i dha disa flakuresha, sa që ma krisi timpanin e veshit dhe veshi u mbush me gjak, ai dha urdhër që ta sjellin F.I. për të dëshmuar se ç'farë detyre i kam dhënë. Në fillim F.I. i vinte keq të dëshmojë, dhe ngurronte të fliste, por kur Çedo Topallovit ju kërcënoi, F.I. e zgjidhi gjuhën, duke treguar fill e për pe për të gjitha ato që i dinte. Por do ta kisha dalluar Ibër Haskun dhe me Sllavkun me të cilët nuk mund të krahasohet asnjë udbash. Ata pasi m'i enjtën dhe m'i nxinin duart e këmbët me kërrbaç ("pendrek"), sa që memzi mund të ecja, e gjetën një metodë edhe më barbare që e kanë krijuar sigurimet e diktatorëve komunistë. Ata kishin qenë xhelatë dhe sadistë të vërtetë. Një natë, ku ta dijte se sa ishte ora, rojtarët e burgut më dërguan në zyret e UDB-ës. Më ulën në karrike dhe më "shpjeguan" për « detektorin e rrenëve » siç e quanin ata. Më thanë se do të m'i shtrojnë disa pyetje. Poqese unë rrejë, aparati do të më dridhë. Poqese e them të vërtetën, aparati nuk do të më dridhë! Në fillim, me nga një tel m'i lidhën dy gishtërinjtë e veçgjël të duarve e pastaj dy veshët. Një udbash ma mbante një dorë, tjetri dorën tjetër. Sllavku ishte i ulur pas tavoline dhe më bëri pyetjen e parë se a jam anëtar i Organizatës? Pas përgjigjes time mohuese filloi i tërë trupi të më dridhet, kurse piskamën, nuk kisha mundësi ta ndalja. Pas disa pyetjeve, i erdhi radha pyetjes se a e njoh Adem Demaçin. Edhe pse u përgjigja me jo

dhe prisja dridhje e dhembje të padurueshme, ndodhi e kundërt!!! Sllavku më tha :
- A po sheh, nuk të dridhi, sepse e fole të vërtetën! Nuk bëra zë, por e kuptova se ata nuk kanë njohuri se unë jamë takuar me Adem Demaçin! Herën e dytë, pas një jave, prapë më thirrën udbashët natën vonë. Tani kryexhelat nuk ishte Sllavku, por ishte Ibër Hasku. Ishte ku një djalë i ri, çubardhak, i gjatë, dikund tridhjet e tre-katër vjeçar dhe i pashëm shumë. Më bënte pyetje veç

serbisht. Unë i përgjigjsha shqip. Seancat e shokut elektri ishin të gjata dhe të forta, kur «detektorin e rrenëve» e komandonte Ibër Hasku. Ai për t'u treguar rob besnik ndaj padronit, atë natë u bë më bi-shë se bisha e egër. Për fat, iu përballova torturave më çnjerzore që mund të bëhen. Më kthyen në qelinë nr. 20, e cila ishte e shtruar në beton. U shtriva gjerë e gjatë në beton. I tëri dridhesha. Veçmas koka dhe duart. Kisha përshtypjen se duart janë bërë tepër të rënda dhe shumë më të mëdha se që ishin. Nga dridhjet e duarve dhe kokës nuk mundja ta ha gjellën as çajin. Kjo vazhdoi pothuajse një javë. Ditët kalonin me vështirësi. U bë një muaj i plotë që flija mbi beton, pa shtrojë dhe pa mbulojë. Kisha shumë të ftohtë natën. Këpucët i veja nënë kokë në vend të jastakut. Një fshisë e vogël, që kishte qëlluar në qeli e fusja nën bri. Me setër (pallto) pa e zdashur, e mbuloja fytyrën që, nëpërmjet frymës time, disi të nxehem. Në mëngjes, kur gardianët e panë se kam rënë për të fjetur mbi fshisë, ma muarrën, duke më akuzuar se e paskam prishur fshisën! Sërish përjetova tortura të tilla. Por, një ditë, në pamundësi që t'i duroj ato, tentova të bëjë vetëvrasje. Kjo gjë m'i ndali torturat. Si duket kishin urdhëra të prerë që t'i shmangen krijimit të martirëve tjerë, pas mbyrtjes kohë më parë po në këtë burg të shokut tonë, Fazli Graicevcit.



METUSH KRASNIQI

DRITA: Kur iu dënuan dhe me kë dolët në gjykim?

Sh. Jashari: Jam dënuar në vitin 1964, gjithësesi para Vitit të Ri. Në mos u gabofsha, në muajin gusht të po këtij viti e patën dënuar Adem Demaçin së bashku me Udhëheqësinë e ngushtë të Organizatës. Unë kam dalur në gjyq së bashku me Enver Mehmetin, Hilmi Rakovicën, Vezir Ukën dhe Selman Berishën. Ende pa u kryer procesi gjyqësor u shtriva në Spitalin e Pri-

shtinës, për shkak të pëlcitjes së zorrës së verbër. Kështu, unë u dënova më vonë për shkak të operimit tim në spital. Të gjithë ne ishim të akuzuar si anëtarë të LRBSH-ës. Sapo u këndella pak nga operimi, pas një muaji, i njëjti gjyq që i kishte dënuar edhe shokët e mi, më dënoi mua me pesë vite burg të rëndë.

DRITA: Kënd e kishit lënë në familje pas arrestimit dhe dënimit tuaj?

Sh. Jashari: Prindërit, ka tërë vëllezër e një motër, të gjithë më të ri se unë.

DRITA: Ku e vuajtët dënimin, me kë ishit atje dhe a iu lëshuan edhe

Juve para kohe, për shkak të disa faljeve që iu bënë anëtarëve të Organizatës suaj pas Plenumit të Brionëve?

Sh. Jashari: Gjyqi i Qarkut, për shkaqe shëndetësore, ende pa e marrë dënimin formen e prerë, më dërgoi për vuajtjen e dënimit në burgun famkeq të Goli Otokut. Pas meje aty i sollën edhe: Sabri Novosellën, Avdyli Lahun, Teki Dervishin, Shaban Kelmendin, Fadil Cukën, Shefki Muqën, Haxhi Zibën, Azem Ramadanin, Hasan Polluzhën, Avdyli Gjevukajn dhe Irfan Bikliqin (të dënuar në Armatën jugosllave). Shukriu dhe Hajdini, të dënuar për spiunazh në dobi të Shqipërisë, etj. Ka pasur edhe shumë të rinj për vrasje dhe vepra tjera. Gjyqi Suprem

ma pat zbritur dënimin, prej pesë në tri vjet burg. Mirëpo, falë disa rrethanave të çuditshme unë i mbajta më shumë se tre vite. Unë jam lëshuar njëzet e dy ditë pas kohe. Jam burgosur më gjashtë korrik 1964 dhe jam lëshuar më njëzet e tetë korrik të 1967 pra, tre vite e njëzet e dy ditë. Administrata e gjyqit ka bërë gabim kur e ka shtypur Vendimin. E ka shënuar se unë jam burgosur më 28.07.1964. Edhe pse e njohtova Drejtorinë e Burgut për gabimin e lëshuar nga administrata e gjyqit, ajo nuk bëri asgjë që ta përmirësojë gabimin në fjalë.

DRITA: Pas daljes nga burgu a ju kujtohet se në çfarë gjendje ishte Kosova atëbotë?

Sh. Jashari: Pasi klani i Titos fitoi mbi klanin e Rankoviqit, atmosfera në Kosovë kishte ndryshuar dukshëm. Optimizmi i shqiptarit dukej çdo kund: në biseda rasti, nëpër oda, nëpër mbledhjet e fshatarëve dhe qytetarëve që i organizonte Lidhja Socialiste nëpër fshatra dhe qytete, përkitazi me ndryshimet kushtetuese. Njerëzit e kishin pas hequr frikën plotësisht. Bashkëpunorët e Sigurimit Shtetëror, populli haptas i quante "rankoviqa" pra, me fjalën më të urryer dhe më poshtëruese, gjë që edhe e meritonin.

DRITA: Si u gjendet në rrethanat e reja të Kosovës?

Sh. Jashari: Kur u ktheva nga burgu, gjendja ekonomike e familjes ishte e vështirë. Pensioni i babës nuk mjaftonte për të siguruar kushtet elementare për të jetuar. Motra s'kishte pas mundur ta vazhdojë shkollimin e mesëm, pasi që është dashur për t'iu paguar qiraja e banesës në Prishtinë apo në Vushtri. Mundësitë materiale kanë munguar për një gjë të tillë. Tre vëllezërit ishin ende në shkollimin fillor. Edhe pse kisha dëshirë të madhe t'i vazhdoja studimet, gjendja jo e mirë materiale, më shtyri të kërkoja çfarëdo pune nëpër ndërmarrjet e Kosovës. Pasi nuk gjeta askund punë, në vjeshtën e atij viti, unë sëbashku me një kushëri e çelëm një xehorë në arën time, për të nxjerrë thëngjill. Fshatarët e Artakollit e përdornin për nxemje thëngjillin. Pas një viti pune në

xehorore, u regjistrova në Shkollën e Lartë Pedagogjike, në Prishtinë. Pra, në vitin 1968 e regjistrova degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Më vitin 1970 e kreu SHLP dhe u punësova në Shkollën fillore në Gllavotinë. Më vonë, me huanë popullore, në Strofc u ndërtua Shkolla fillore dhe aty punova si mësues gjuhe, deri më vitin 1977. Atë vit më larguan nga procesi mësimor. Kuvendi dhe Komiteti Komunal i Vushtrrisë, siç thonin ata, për shkaqe se isha "i papërshtatshëm" për t'i edukuar nxënësit, pasi kisha qenë i dënuar më parë, pra për shkaqe politike më larguan nga procesi mësimor. Një vit mbeta në shtëpi pa punë. Pas një viti, KK i Vushtrrisë më gjeti punë si përkthyes në Fabrikën e konfeksionit "Polet" në Vushtri. Pas shtatë-tetë muajsh me ndihmën e ca dashamirëve dhe të një kushëriri gjeta punë si përkthyes në KXM "Kosova", në Obiliq, në repartin e Seperacionit. Aty punova deri sa u burgosja për herë të dytë, më 15.11.1979.

DRITA: Si i pritët ndryshimet kushtetuese të 1968 dhe demonstratat e atij viti?

S. Jashari: Ishte e kuptueshme, se me fitoren e klanit të Titos mbi atë të Rankoviqit, duhej bërë edhe ndryshime kushtetuese. Titoja duke u nisur nga parimi: "Sa më e dobët që të jetë Serbia, aq më e fortë do të jetë Jugosllavia" vendosi që të formohen Komisionet Federatveve, Republikane dhe Krahinore, për t'i bërë ndryshimet kushtetutare. Në tërë Kosovën, në fshatra dhe në qytete Lidhja Socialiste (e më vonë edhe ajo komuniste) organizoi tubime për t'i shtruar dhe shqyrtuar ndryshimet kushtetare të Kosovës. Populli shqiptar në të gjitha tubimet ka kërkuar që Kosova ta fitojë statusin e Republikës, duke u arsyetuar në faktin se kur mundet për të qenë Mali i Zi Republikë, me një territor për afërsisht sa të Kosovës dhe me një popullësi shumëfish më të vogël - pse të mos jetë edhe Kosova Republikë? Poashtu, hudhej poshtë mendimi se nuk bën të jenë dy shtete shqiptare në Ballkan. Këto arsyetime falco hidheshin poshtë me fakte: atëherë ishin dy shtete gjermane, dy shtete vietnameze, dy shtete koreane etj. Në fillim të diskutimit publik, disponimi në Federatë dhe në Organet udhëheqëse të Kosovës ishte që Kosova ta

gëzoi statusin e Republikës, por më vonë, ai disponim ndryshoi me intervenimin e Fadil Hoxhës, i cili e stopoi këtë kërkesë të ligjëshme (me urdhër të kujt? - kjo ende nuk dihet.). Në ato kushte të favorshme u organizuan dhe u mbajtën demonstratat në disa qendra të Kosovës, që kishin thjesht karakter kombëtar dhe politik. Këto patën një rëndësi të madhe për Lëvizjen tonë Kombëtare. Por ato i ndihmuan edhe politikës së Titos që mbështetej në parimin: »Sa më e dobtë që të jetë Serbia, aq më e fortë do të jetë Jugosllavia«. Ato e neutralizuan deri dikund reacionin e shovenizmit serb dhe e detyruan atë ta pranojë një kompromis që Kosova ta ketë një status më të avancuar se më parë. Këto të drejta i arrijti populli ynë, jo se ato i kanë kërkuar ndonjëherë kukullat serbe në Kosovë, por në saje të rezistencës së vazhdueshme të popullit tonë, si dhe në saje të politikantit dhe strategut të zgjuar të popujve jugosllav, Titos, i cili shikonte më largë dhe më mirë se të gjithë bashkëkohasit e tij në udhëheqësinë e atëherëshme jugosllave. Në ato kohëra të bujshme të historisë tonë kombëtare, ishte grumbulluar një energji gjithëpopullore, një optimizëm dhe një shpresë e fuqishme se më në fund, shqiptari e mori rrugën e shpëtimit, rrugën e fitorës, se intelgjencia që po krijohet do të jetë e zonja t'iu përballojë presioneve serbe dhe, në momentin e duhur, do t'i prijë popullit drejt fitorës së sigurt. Rinia shkollore dhe ajo studentore, kishte një vetëdije të lartë kombëtare. Prandaj në ato kushte, Grupi i të Rinjëve, ish anëtarë të Organizatës Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve të Adem Demaçit, nuk e kanë pasur edhe shumë vështirë t'i organizojnë demonstratat. Isha student i Shkollës së Lartë Pedagogjike. Pothuajse, çdo ditë shkoja për ta kaluar një pjesë të kohës së lirë në duqanin e Sabri Novosellës, që e kishte në qendër të Prishtinës, afër Teatrit Krahinor. Duqani i Sabriut ishte një vendtakim për ish të burgosurit politikë, jo vetëm të Prishtinës, por edhe të regjioneve tjera të Kosovës. Aty kam pasur rastin të takohem me shumë shokë, për të cilët kisha dëgjuar më parë si emra. Aty jam njohur edhe me Metush Krasniqin, Hyda Dobrunën dhe me shumicën e antarëve të Grupit të të Rinjëve, që i patën organizuar demonstratat e 68-tës. Ata

patën marrë vendim të logjikshëm dhe të pjekur, që ish të burgosurit politikë të mos marrin pjesë në demonstrata. Por, pasi unë isha student i rregullt, nuk doja që ai Vendim të më ndaloj të mos marrë pjesë në demonstrata. Një takim që e patëm në duqanin e Sabri Novosellës, së bashku me Metush Krasniqin, biseduam për përgaditjet që kishin bërë Grupi i të Rinjëve. Atë mbrëmje Sabriu na njohtoi për përmbajtjen e parullave, të cilat i përgadisnin organizatorët e demonstratave. Po atë natë Sabriu na njohtoi për mospajtimet në mes të Udhëheqësve të demonstratave sa i përket parullave: "Kosova Republikë", apo "Vetëvendosje deri në shkëputje". Ne ishim të mendimit se kërkesa e Vetëvendosjes është më e përshtatshme për ne. Atëherë shprehim frikën që, poqese Kosova do të bëhet Republikë, do të krijohet një shtresë e privilegjuar nga radha e shqiptarëve, që do ta luftonin bashkimin kombëtar. Si shembuj i mirrim popujt e ndarë në nga dy shtete si dhe Maqedoninë, nga e cila Tito e krijoi një komb të ri, ndonëse popullsia ishte me prejardhje bullgare. Po atë natë, e kërkova mendimin e Metush Krasniqit dhe të Sabri Novosellës se, a është e arsyshme të marrë pjesë në demonstrata. Shprehja dëshirën e flaktë që të marrë pjesë në to, duke u arsyetuar me faktin se isha student. Fakti tjetër ishte se, me shokët e studimeve: Banush Xhemshitin dhe Ilimi Malokun kishim bërë së bashku ca organizime në ShLP, Fakultetin Ekonomik dhe atë të Drejtësisë. Fakt tjetër që se, Sabriu, ia dhashë këngën e Internacionalës, të cilës unë ia pata ndryshuar ca fjalë dhe ca rreshta. Kjo këngë do të këndohej në demonstrata. E pata titulluar «Poshtë padronët e padrejtësisë». Sabriu ia përcjelli këngën në fjalë Grupit të Rinjëve, Ilimi Malokut dhe Banush Xhemshitit. Pastaj këta këtë këngë ua shpërndanë studentëve të besueshëm, në mënyrë që ta mësojnë për ta kënduar gjatë manifestimeve nëpër rrugët e qyteteve të Kosovës. Mosmarrja ime pjesë në demonstrata, ju thash Sabriut dhe Metushit, do të keqëkuptohej jo vetëm nga Banushi e Ilimiu, por edhe nga shokët tjerë që studjonim bashkë. E mora pëlqimin që të mos ndahem nga shokët dhe studentët e SHLP F. Teknik, F. Ekonomik dhe F. Juridik. Aty pat filluar demonstrata, përafërsisht, ku është tani Biblioteka Universitare. Parullat dhe

flamujt i pat sjellur Selatin Novose-lla. Pjesëmarrjen time në demonstratën e 68 e konsideroj si një nga momentet më të gëzuara të jetës sime. Pjesëmarja në to, për mua ishte një privilegj, që ma ka dhuruar i Madhi Zot, për ta shijuar gëzimin dhe krenarinë e vërtetë, për ta kuptuar fuqinë e organizimit, për të parë trima dhe trimëresha, siç u treguan: Mejreme Berisha, e cila me Flamur Kombëtar ju prini demonstruesve, kur numri i demonstruesve ende ishte shumë i vogël. Për ta parë Banush Xhemshitin, në rendin e parë të demonstruesve, i cili me atë grushtin e tij të fuqishëm e zhbllokoi rrugën që e kishin zënë policët, duke e hudhur një polic si të pashpirt për tokë, kurse të tjerët ikën duke zbratur ca fishekë në ajër. Pashë atë natë shumë trima e trimëresha, që me plagë dhe me plumba në trup, ecnin përpara me demonstruesit tjerë, pa ia vënë mendjen plagëve të tyre që kullonin gjak. Kujtimet e ngulitura në mendje dhe në shpirt të atyre ngjarjeve të rëndësishme kombëtare më kanë ndihmuar t'i kalojë mërzitë dhe hallet e shumta, që më kanë përcjellur gjatë tërë jetës time, sepse rikujtimi i atyre ngjarjeve në situata dhe momente të vështirësive të mëdha jetësore më jepnin forcë për t' i kaluar ato.

DRITA: Gjatë viteve të 70-ta ishte një frymë paksa më liberale në Kosovë. Gjatë kësaj kohe lindi edhe LNÇKVSHJ-a. Meqë Ju jeni njëri nga themeluesit e LNÇKVSHJ-ës, a ka mundësi të na thuani për gazetën DRITA se kur u krijua kjo Lëvizje, kush mori pjesë në themelimin e saj, si u organizua Lëvizja në fjalë, dhe cili ishte qëllimi i themelimit të saj.

Sh.Jashari: Me marrjen fund të procesit gjyqësorë të 1975, ku u dënuan veprimtarë të dalluar me në krye Adem Demaçin, ishte e qartë se pushteti kukull i Kosovës, është në gjendje ta burgos dhe ta dënojë çdonjërin që UDB-a ia vente syrin, edhe pse nuk kishin fare prova për vepra të kryera penale, sipas Ligjit jugosllav. Duke e ditur se me vdekjen e Titos, nuk do të ketë personalitet që do t'i mbajë nën kontroll nacionalizmin kroato-sllloven dhe shovenizmin serb dhe, si rrjedhim i kësaj gjendje, do të vijë deri te shkapërderdhja e Federatës

Jugosllave, Metush Krasniqi Sabri Novose-lla dhe unë, pas bisedave të shumta, që i zhvilloni herë në shtëpinë e Sabriut e herë në shtëpinë e Metushit, por duke u konsultuar çdo njëri prej nesh edhe me shokë që kishim besim të plotë, vendosëm që ta formojmë një Organizatë, thjesht kombëtare, pa ngjyrimë ideologjike. Donim t'ishim të përgaditur, në mënyrë që, në momentin e duhur, Lëvizja jonë të jetë e zonja t'i prijë popullit për t'i prerë prangat e robërisë dhe për ta realizuar ëndrrën e shenjtë - çlirimin e Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me Nënë Shqipëri. Parapërgaditjet kanë filluar në pranverë të vitit 1976 dhe kanë zgjatur disa muaj. U muarëm vesh në fillim që, çdonjëri prej nesh t'i zgjedhë shokët me të cilët do të punojë në formimin e celulave të para. Këto celula të të formohen prej njerëzve që s'kanë qenë të burgosur politikë, që për pushtetin kukull të Kosovës të mos jenë të përcjellur, të jenë autoritativë në vendet ku jetojnë dhe punojnë, të kenë aftësi organizative, përvojë jetësore dhe, mbi të gjitha, të jenë atdhetarë të mirëfilltë. Poashtu, u muarëm vesh që për emrin e Organizatës të vendosim më vonë, pasi t'i konsultojmë edhe shokët me të cilët do të veprojmë. Ishin dy propozime: njëri, për emrin e Organizatës së Adem Demaçit dhe tjetri për LNÇKVSHJ. Ishin pushimet verore të vitit 1977, kur vendosëm ta bëjmë mbledhjen për formimin e Organizatës. Këtë mbledhje e mbajtëm në shtëpinë e Sabri Novosellës. Çdo njëri raportuam për punën tonë. Nga sa celula i kemi formuar, në cilat qytete apo fshatra veprojnë ato, kush janë ata që e udhëheqin veprimtarinë e celulës, natyrisht pa i prezentuar me emra dhe mbiemra, por duke iu treguar biografite të tyre. Bilansi i përgjithshëm i punës tonë ishte kështu: unë i pata formuar dy celula, Sabriu tri celula, kurse Metushi i kishte formuar pesë celula, njëra nga këto celula kishte qenë e formuar në Shkup. Shumica e njerëzve të pyetur nga ne kishin shprehur dëshirën që Organizata ta merë emrin LNÇKVSHJ. U vendos që Metush Krasniqi të jetë kryetar i Lëvizjes. Vetëm atij t'ia tregojmë emrat e vërtetë të përgjegjësve të celulave dhe të gjitha fshehtësitë tjera. U vendos që celulat e formuara t'i shëndrrojmë në Komitete Qarkore (Komitete të komunave) dhe përgjegjësit e atyre të jenë kryetarë të

Komiteteve Qarkore. Që Kryesia e Komiteteve Qarkore të jetë prej tre anëtarësh. Që çdo anëtarë i tyre të formojë Komitete të Vendit, në qytete, fshatra, organizata punuese etj. Ishte porosi e prerë që të kihet kujdes në mënyrë që të mos depërtojnë në radhët tona njerëz, të cilët mund t'i sillnin dëme Lëvizjes drejtë-përdrejtë apo tërthorazi. U muarëm vesh që anëtarët e udhëheqësive të Komiteteve Qarkore të mos ia tregojnë njëri tjetrit emrat e përgjegjësve të Komiteteve të Vendit, si dhe u muar Vendim që askush nuk guxon ta pranoj askend për anëtar të Lëvizjes pa e njohur mirë më së paku dy vjet. Po ashtu u vendos që në vend të emrave të përdorën pseudonimet. Atë ditë u krye edhe betimi, tekstin e të cilit e pat përgaditur Sabriu. Betimi u bë para fotografisë së Skënderbeut dhe Flamurit Kombëtar. U muarëm vesh që Projektstatutin e Lëvizjes ta përgadis Metush Krasniqi, i cili


ishite jurist. Takimi tjetër për aprovimin e Statutit u vendos ta bëjmë në shtëpinë e Metush Krasniqit. Për çështjet që diskutuam atë ditë e kishim edhe mendimin e të gjithë përgjegjësve të celulave të formuara. Prandaj, vendimet e marra atë ditë ishin në përputhje të plotë me mendimet e përgjegjësve të celulave të formuara. Vetëm kur ishte çështja e zgjedhjes së kryetarit të LNÇKVSHJ-ës, nuk ishim unanim. Metush Krasniqi ishte i mendimit që zgjedhja e kryetarit të bëhet në një mbledhje të përbashkët, ku do të votonin të gjithë antarët e udhëheqësive qendrore. Unë dhe Sabriu, duke e njohur aftësitë e tija organizative, cilësitë e një udhëheqësi popullor, i pafektuar nga ideologjia bolshevike, me synime demokratike, me një trimëri të pashoq që e kish treguar gjatë hetimeve policore në gjykatoret dhe burgjet serbosllave, me be-

simin e madh që gëzonte nga atdhetarët e të gjitha shtresave të popullësisë, ishim të bindur se Metush Krasniqi i takonte ta mirrte edhe përgjegjësinë më të madhe. Prandaj, ne kërkuam që ai të jetë kryetar i Lëvizjes, për të cilën gjë unë dhe Sabriu votuam. Në fund të mbledhjes unë dhe Sabriu, veç e veç, ia kemi treguar emrat e vërtetë të përgjegjësve të celulave. Me këtë akt Metush Krasniqi (përkundër refuzimit të tij që zgjedhja e kryetarit të bëhet në këtë çast) faktikisht u bë kryetar i Lëvizjes. Pas dy muash u mbajt Mbledhja për shqyrtimin e Projektstatutit. Janë bërë ca ndryshime të vogla me kërkesën e Sabriut dhe të dy kryetarëve të Komiteteve Qarkore.

DRITA: Eshtë e njohur ajo se Lëvizja ishte tejet konspirative. A ju kujtohen shtyllat themelore në të cilat është mbështetur veprimtaria Juaj ilegale?

Sh. Jashari: Për të mos ardhur te zbulimi i plotë i Lëvizjes, siç kish ndodhur në Orga-

nizatat e mëparshme, ne vendosëm që konspiracioni të jetë në shkallën më të lartë që ishte e mundur. Dua ta marrë si ilustrim vetëm një rast prej shumë rasteve tjera të ngjajshme. Ta zëmë, rastin kur është futur në Kryesinë e ngushtë Jusuf Gërvalla. Unë nuk kam ditur si quhet, çfarë profesioni ka, ku punon dhe jeton dhe ku ka lindur. Sabriu ka thënë se e njoh një kohë të gjatë, është atdhetar i mirëfilltë, dmth. i pa infektuar nga ideologjia e djallit të mallkuar bolshevik. Rrjedhë nga një familje me tradita kombëtare, është i zoti i gishtit dhe i penës. Eshtë i organizuar në një grup prej 5-6 vetësh. Më në fund, Sabriu propozoi që në Kryesinë e ngushtë të pranohet përpos tij edhe një bashkëpunëtor i tij. Veprimtaria jonë ilegale ka ecur në këto drejtime: 1. Që në të gjithë Kosovën dhe në të gjitha Viset shqiptare nën okupimin jugosllav ta kemi



ADEM DEMAÇI

një strukturë udhëheqëse dhe organizative të përbërë nga atdhetarë të zot, që në momentin e duhur t'u dalin zot Viseve shqiptare, t'i prijnë popullit në Luftën Çlirimtare për t'i prerë prangat e robërisë; 2. Që kuadri udhëheqës i Lëvizjes dhe anëtarësia e saj të ngritën në pikpamje kombëtare, intelektuale, dhe ushtarake, nëpërmjet leximit të literaturës përkatëse; 3. Armatimi i çdo anëtari të Lëvizjes me pushkë automatike dhe mjete tjera luftarake, kaqenë detyrë parësore; 4. Të dijmë se ku ruhet armatimi i Mbrojtjes Territoriale, lloji i armatimit dhe sasia që disponon çdo komunë. Të dijmë për kuadrin udhëheqës (oficerët) të Mbrojtjes Territoriale; 5. Që një-rëzit tanë t'i fusim nëpër organet udhëheqëse të pushtetit, në të gjitha nivelet, që nga Komitetet Komunale, Komitetin Krahinor, e duke e përfshirë edhe Sekretariatet e Punëve të Brendshme; 6. T'i zbulojmë spiujt dhe në momentin e përshtatshëm t'i likuidojmë ata; 7. Kemi shkruar punime të ndryshme duke rrahur çështje politike dhe kombëtare, që ishin në atë kohë aktuale; 8. Kemi bërë përgaditje për nxerrjen e Organit të Lëvizjes "Zëri i Kosovës" 9. Kemi ndikuar te familjet e mira që t'i dërgojnë fëmijët e tyre nëpër shkolla ushtarake për të studjuar artin ushtarak; 10. Kemi pasur kontakte me përfaqësuesit e Shqipërisë në Konzulatën e Shqipërisë, në Stamboll; 11. Kemi dërguar protesta me shkrim Organizatave të ndryshme të OKB-ës për gjendjen e shqiptarëve nën okupimin serbo-sllav, dhe kemi kërkuar lirim të Adem Demaçit nga burgu. Nëpërmjet njerëzve tanë që kanë pasur shokë të ngushtë në udhëheqësinë e Kosovës, jemi njohtuar rregullisht për debatet dhe vendimet që ka marrë Komiteti Krahinorë i Kosovës etj.

DRITA: Po thua se Jusufi u fut në udhëheqjen e ngushtë të LNÇKVSHJ-ës, sipas propozimit të Sabriut, por megjithatë, thoni se s'e keni njohur fare! A nuk mirrte Jusufi pjesë në mbledhjet tjera të udhëheqjes, ku ai tashmë ishte zgjedhur? A ka mundësi t'i përmendni me emra se kush mirrte pjesë në mbledhjet e Juaja dmth. të Udhëheqjes së ngushtë të Lëvizjes?

Sh. Jashari: Për shkak të konspiracionit u vendos që për një kohë të caktuar të mos tubohet e tërë udhëheqja qendrore, por ne të tretë: Metushi, Sabriu dhe unë të jemi li-dhje e komunikimit e të gjithë anëtarëve të udhëheqësisë qendrore, kur kemi të bëjmë për të shqyrtuar ndonjë propozim, apo për të marrë ndonjë vendim. Siç e kam cekur edhe në një pyetje të shtruar më parë, për strukturën udhëheqëse, për emrin e Organizatës, për shqyrtimin e Projektstatutit dhe aprovimin e tij, janë bërë diskutime dhe është marrë mendimi i të gjithë përgjegjësve të celulave dhe për çdo gjë kemi vendosur në bazë të mendimit të shumicës. Edhe pas formimit të Lëvizjes, kemi punuar në të njëjtën mënyrë. Dua tua tregoi edhe një rast i cili e ilustron më së miri se me çfarë fanatizmi u zbatua konspiracioni te ne. Në një mbledhje Sabriu e bëri kërkesë t'ia gjejmë një makinë shkrimi për nevojat e Lëvizjes. Një shok imi, që ishte kryetar i një Komiteti Qarkor dhe anëtar i udhëheqësisë së ngushtë, ma dha makinën e tij të shkrimit. Sabriu ma caktoi ditën, kohën, parullën (pseudonimin) dhe vendin ku do t'ia dorëzoj makinën shokut të Lëvizjes, të cilit edhe ia dorëzova. Tek pas 10-12 vitësh, pra në shkurt të 1990, kur Sabriu erdhi të më vizitonte në Curih të Zvicrës nga qyteti Malmo i Suedisë, (unë sapo kisha ikur ato ditë nga Kosova - praktikisht nga Zagrebi), më tregoi se makinën e shkrimit në fjalë unë ia paskësh dorëzuar Jusuf Gërvallës! Kjo shpjegon vetvetiu se çfarë konspiracioni i thellë është mbajtur mes nesh. Ndonëse unë e kam njohur Sabriun me dhjetra vite, pastaj së bashku i kemi vuajtur dënimet në burgun e Goli Otokut, ishin në përbërjen e Udhëheqjes së ngushtë të LNÇKVSHJ-ës, mirëpo, kur ishte fjala për rregullat e konspiracionit - ato i kemi zbatuar me rigorizitet të tillë që rrallë herë ka ndodhur në veprimtarinë ilegale të Kosovës. Ditën e formimit të LNÇKVSHJ-ës Udhëheqësia Qendrore, që ne e patëm quajtur Komiteti Qendror ka pasur nëntë anëtarë: Metush Krasniqi me dy kryetarë të Komiteteve Qarkore; Sabri Novosella dhe unë poashtu me nga dy kryetarë të Komiteteve Qarkore. Në këtë Udhëheqësi pastaj janë pranuar, me propozimin e Sabriut, Jusuf Gërvalla vet i dyti, Ramadan Pllana, i propozuar nda unë, në cilësinë e kryetarit të

Rinisë së LNÇKVSHJ-ës,dhe tre kryetarë të Komiteteve Qarkore të propozuar nga Metush Krasniqi.Pra gjithsejt 15 anëtarë. Natyrisht, edhe me këtë rast, nuk janë përmendur me emra ata që s'ishin të pranishëm në mbledhje.

DRITA:E përmendët Zërin e Kosovës. A arritët ta nxirrni ndonjë numër të tij në Kosovë?

Sh.Jashari: Fatkeqësisht jo.

DRITA: A keni qenë të detyruar ta bëni betimin për pranimin në Lëvizje dhe a Ju kujtohet sesi ishte teksti. Ju, personalisht, para kujt e keni dhënë betimin?

Sh.Jashari: Betimi ka qenë i detyruar për gjithkënd. Unë e kam dhënë para Flamurit Kombëtar dhe fotografisë së Skënderbeut,në prezencën e Metush Krasniqit dhe Sabri Novosellës.Do ta them përmbajtjen e tij,por,nuk jam i sigurt se do ta them të plotë, sepse kanë kaluar kaq vite: *»Beto hem në flamurin kombëtar, se të gjitha aftësitë e mia fizike,psikike dhe mundësitë e mia materiale do t'i vej në shërbim të popullit dhe do të jem i lumtur poqese flijohem për çlirimin e Kosovës e Viseve tjera Shqiptare dhe bashkimin e tyre me Nënë Shqipëri».*

DRITA: Pas sa vitesh iu ra në erë UDB-a dhe cili qe njeriu i parë i Lëvizjes Suaj që u arrestua ?

Sh.Jashari: UDB-a na ra në erë, si duket pas tre vitesh, në saje të përcjelljeve të shumta,veçmas pas dërgimit të Ramadan Pllanës për t'i vazhduar kontaktet mes përfaqësuesit të LNÇKVSHJ-ës dhe të përfaqësuesve të Shqipërisë, në Stamboll. Eshtë e mundshme që Sigurimi jugosllav të na ketë zbuluar, nëpërmjet rrjetit e çerdheve të Sigurimit të saj të krijuara në Shqipëri dhe kudo në botë.Përfaqësuesi i Shqipërisë në Stamboll, nuk ka dashur të bisedojë me Ramadan Pllanën pa ia treguar emrin dhe mbiemrin tim të vërtetë. Në takimin që e bëm me Ramadan Pllanën në parkun e qytetit të Prishtinës, ku ai më informoi për rrjedhën e bisedimeve në Stamboll,e patëm

vërejtur se jemi të përcjellur.Edhe në një takim që e pata me Sabri Novosellën, në të njëjtin park, e ku unë e informoja atë për misionin e Ramadan Pllanës në Stamboll,e vërejta se pasi e kreu takimin, njerëz të panjohur po më përcillnin.Në takimin vijues që e pata me Sabriun i tregova për përcjelljen që më kishin bërë persona të panjohur.I thash se është mirë të ikim jashtë shtetit,por ai nuk e mori si shumë serioze këtë punë. Më pat thënë se me siguri ka qenë ndonjë keqkuptim.Këto përcjellje i kam vërejtur një muaj para se të burgosem. Më sa di unë,Ramadan Pllana është burgosur disa ditë para meje,së bashku me ca anëtarë të Udhëheqësisë së ngushtë të Organizatës së rinisë që e patëm formuar në kuadër të Lëvizjes,ku Ramadan Pllana ishte i zgjedhur si kryetar i saj.

DRITA: A mund të na thoni ndonjë fjalë për Ramadan Pllanën dhe të sqaroni se, përse përfaqësuesi i Shqipërisë e ka kërkuar pikërisht emrin dhe mbiemrin tënd e jo, ta zëm, të Metushit, të Sabriut apo të Jusufit, të cilët poashtu ishin në Udhëheqjen e ngushtë të Lëvizjes?

Sh.Jashari:Ramadan Pllana disa vite kishte punuar në Francë.Para se të kthehet në Kosovë,diplomatët e Shqipërisë i kishin pas dhënë detyrë që ta formojë Partinë Marksiste-Leniniste të Kosovës..Ka filluar studimet e gjuhës frenge në Universitetin e Prishtinës. E pat organizuar një grup të rinjsh të gatshëm për të punuar për çështje kombëtare.Ramadani atëbotë u tregua si një patriot i vërtetë. Duke e parë se më e rëndësishme ishte të bënte aktivitet në një organizatë që mirret me çështje kombëtare sesa ideologjike, vendosi t'i bashkangjitet Lëvizjes dhe të mos krijojë parti marksist-leniniste, siç qe porositur nga diplomatët e Shqipërisë. Sa i përket pyetjes së dytë, edhe më lartë sqarova se ne vepronim me një konspiracion të thellë. Ndaj, përpos Metush Krasniqit, askush tjetër s'i ka njohur emrat e anëtarëve të Komitetit Qendror. Pra, rrjedhimisht, del se Ramadan më ka njohur vetëm mua.Sepse, isha unë ai që ia kam përcjellur detyrat dhe porositë e Udhëheqësisë, ku edhe ai bënte pjesë. Ndaj dhe diplomati i Shqipërisë, e ka dety-

ruar Ramadanin që t'ia tregoi vetëm emrin dhe mbiemrin tim.

DRITA: Kur ju arrestuan juve për herë të dytë dhe ,sipas jush,cila qe rrethana që shpuri deri te ky arrestim?

Sh.Jashari: Dikund kah ora tre e mëngjesit, të datës 15 .11. 1979, shtëpia ime qe rrethuar nga policë dhe udbashë, të cilët kishin ardhur për të më arrestuar. Nuk më hiqet nga mendja frika që përjetuan tre fëmijët e mi të vegjël, njëri trevjeçar,tjetri pesë vjeçar dhe i fundit shtatë vjeçar. Atë ditë, ende pa aguar, fëmijët e mi u tmerruan nga policët e armatosur deri në dhëmbë. Por, edhe sa e sa fëmijë të tjerë të patriotëve, anekënd Viseve shqiptare i kanë përjetuar këto tmerre të okupatorit? Këtë s'e di. Poashtu s'e di as këtë, se cila qe rrethana që shpuri deri te zbulimi i UDB-ës. Unë veç mund të jap një variantë të mundshme. Ne kemi mundur të zbulohemi nëpërmjet spiujve jugosllav nga Shqipëria apo atyre nga Turqia. Variantë tjetër mund të jetë se unë kam shkëlur në ndonjë dërrasë të kalbur dmth., se kam biseduar me dikë që ka qenë bashkëpunëtor i UDB-ës. Në dërrasa të tilla ka mundur të shkelë edhe Ramadan Pllana.Tash për tash, nuk jam i sigurtë se cila variantë është e vërtetë. Me siguri,të vërtetat një ditë do të dalin në shesh,nga historianët tanë,kur do ta kenë në dorë tërë dokumentacionin burimor.

DRITA: Në fillim të hetimeve a munde ta kuptosh se sa ishte e informuar UDB-a për LNÇKVSHJ-ën? Apo, mos, vallë, nga hetimet u zbulua ekzistimi i kësaj organizate? Dhe, cilin nga Ju e trajtuan si kryetar i grupit?

Sh.Jashari: Qysh në fillim të hetimeve shihej se hetuesit e kishin të njohur emrin e Organizatës.Poashtu i përmendnin titujt e shkrimeve që i patën shkruar disa antarë të Udhëheqësisë.

DRITA: Gjatë bastisjeve a i ra në dorë të UDB-ës ndonjë material që fliste për LNÇKVSHJ-ën?

Sh.Jashari: Na dënuan në bazë të dokumentacionit që i pat rënë në dorë UDB-ës,pra Statutit dhe dokumenteve tjera.Mua dhe Ramadan Pllanën na dënuan si Udhëheqës të LNÇKVSHJ,kurse Avdi Kelmendin,Isa Demën, Avdyl Lahun, Hysen Gërvallën,Sylejman Qyqallën dhe Skënder Jasharin si anëtarë të Lëvizjes.

DRITA: Sa u mbajtën në hetuesi, kush qenë hetuesit Tuaj dhe çfarë sjelljesh patën ndaj jush?

Sh.Jashari: Hetimet zgjatën 7-8 muaj. Është vështirë të përmendën të gjithë hetuesit që mirrnin pjesë në maltretime.Veçmas kanë qenë të pashpirtë Asllan Sllamniku,Sllavkoviqi dhe njëfarë Muharremi. Edhe njërin që ata e quanin kryeshef.Kam pasur rastin ta njoh edhe Avdullah Prapashticën,i cili e shikonte duke më rënë me kërbaç këmbëve i pashpirti Asllan Sllamniku. Ai me zgjuarësi ia mori kërbacin A.Sllamnikut,duke më ngritur në këmbë dhe duke më goditur shumë pak hundëve, prej nga më doli gjaku.Si duket A.Sllamnikun gjaku i dalur nga hundët e mia e zbuti. Ai pastaj dha urëdhër që të më kthejnë në burg.Me gjestin që e bëri Avdullah Prapashtica,kam qenë i bindur se nuk është i shitur për serbosllavët,por ka hyrë të punojë në SPB-ën e Kosovës për qëllime patriotike.Të rënat me kërbaç, janë lojëra fëmijësh në krahë me drogat që më janë dhënë nëpërmjet ushqimit nga hetuesit e pashpirtë.Kam qenë kah çmendem nga halucinacionet dhe frika që më krijonin ato. Kam përjetuar skena të llojllojshme trishtuese, të cilat nuk mund t'i shprehi as sot me gojë.Kisha ndjenjen se dimensionet e kokës janë të zmadhuara për së tepërmi dhe se janë të rënduara shumë. Më dukej se i kam katër duar, e gjëra të tjera lemeri-tëse.

-vijon në numrin e ardhshëm-

INTERVISTË ME SHEFQET JASHARIN, ANËTARIN E KOMITETIT QENDROR TË LËVIZJES NACIONAL ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS DHE VISEVE SHQIPTARE NËN JUGOSLLAVI (LNÇKVSHJ)



SHEFQET JASHARI

Intervistoi: **Shefki Oseku.**

-Vijon nga numri i kaluar-

DRITA:Sa iu dënuan dhe ku e mbajtët dënimin dhe au bashkuan me të burgosurë të tjerë politikë

shqiptarë?

Sh.Jashari:Më dënuan me tetë vite burg.Isha në Burgun e Prishtinës kur studentët i bënë demonstratat e para, në mars të vitit 1981.Pas disa ditësh më dërguan në burgun e Gjilanit.Aty më mbajtën tri javë.Në javën e parë të muajit prill, 11 veta na dërguan që në Burgun Komunal të Zajëçarit.Rrugën e kaluam së bashku në një "kombi policie". Me mua ishin edhe Isa Dema, Avdi Kelmendi e Xhabir Morina dhe dy tjerë që tani s'po më kujtohen sesi quheshin. Në burg na shpërndanë pikë e pesë me hajna dhe kriminelë, vëllejë e serbë.Më vonë i sollën edhe Sherif Konjufcën, Osman dhe Lutfi Maqedoncin, Avdi Gjatën, Murat Muratin, Nexhmedin Pirevën dhe Fatmir Sopin.

DRITA: Cili nga këta që Ju i përmendët ishte anëtarë i LNÇKVSHJ-ës,në çfarë qytetesh ishin inkuadruar në këtë Lëvizje dhe si ishin zbuluar,si ishin gjykuar - veç e veç apo bashkarisht, të emruar si antarë të Lëvizjes apo si grup armiqësor?

SH.Jashari: Isa Demaj dhe Avdi Kelmendi,siç thash dhe në pyetjen tjetër,janë dënuar si anëtarë të Lëvizjes sonë. Këta kishin qenë të organizuar në një celulë të

Sabri Novosellës.Kurse Osman dhe Lutfi Maqedonci kanë qenë të dënuar si anëtarë të *Partisë Komuniste Marksiste Leniniste të Shqiptarëve të Jugosllavisë*. Shokët tjerë kishin qenë të organizuar nëpër organizata dhe grupe të ndryshme, të zbuluara pas demonstratave të vitit 1981.

DRITA: Kur more vesh për ikjen e Jusuf Gërvallës dhe Sabri Novosellës jashtë ish Jugosllavisë dhe si e përjetove atë?

Sh.Jashari: Pas Vitit të Ri 1980,në qelinë time ma sollën S.P.,tregëtar i një ndërmarjeje pemësh dhe perimesh.Paditej për vjedhje.Në bisedë e sipër më tregoi se e kanë sjellur tek unë për të më spiunuar.Ai më tregoi për shumë gjëra që kishin ndodhur në Prishtinë.Veçmas po flitet, më tha ai, për ikjen e një këngëtari i cili në mandolinën e tij i kishte fshehur shumë dokumente të rëndësishme. Fjala kishte qenë për Jusuf Gërvallën, i cili në atë kohë kish ikur në Perëndim. Mirëpo, Jusufit ky farë tregëtari nuk ia dinte emrin. Po, edhe sikur të ma kishte thënë,unë s'kisha për ta ditur se në cilën Organizatë ka bërë pjesë Jusuf Gërvalla,pasiqë në fund të vitit 1979 kanë pas rënë nëpër burgje disa grupe të disa organizatave të ndryshme. Mirëpo,kur më tha se ka ikur edhe njëfarë Sabri Novosella, ndjeva një gëzim të papërshkruar. Megjithatë, u përmbajta që ai të mos zbuloj gjë. Siç dihet tashmë, Sabriu kishte ikur në Shqipëri, prej nga kishte shkuar në Stamboll të Turqisë. Kurse Jusufi, në Austri, e nga aty kishte shkuar në Gjermani.

DRITA: A keni ndonjë kujtim të paharruar për ata djem të rinj që atëbotë dergjeshin nëpër burgjet e panumërta serbosllave?

Sh. Jashari Të gjithë ata të burgosur që i përmenda më parë i meritojnë fjalët më të mira. Por është edhe një, për të cilin kam respekt të veçantë. Ky është Hajdin Abazi, i cili i takonte një Organizate tjetër. E njoh qysh nga ditët e para kur u burgosëm, si një guximtar i pashembullt. Ai sa herë që mua më nxirrnin për të shetituar në oborrin e burgut, hypte në dritare dhe më përshëndette me dorë, por duke më ngushilluar edhe me fjalë burrërie dhe trimërie. Ishte guximtar i tillë, me të cilin unë krenohesha, ndonëse nuk e njihja personalisht.

DRITA: Pas daljes nga burgu ku jetove?

Sh. J.ashari: Para se të burgosem, kam jetuar në Stroč. Pas burgosjes ime vëllezërit ma kishin pas sjellur familjen në Prishtinë. Me të dalë nga burgu, një kohë ndejta te vëllezërit, meqë që shtëpia që e kam pasur në fshat ishte dëmtuar shumë dhe kishte rrezik të shembej. Kur u martua vëllau pas meje, u detyrova ta gjejë një banesë me qira. Shtëpia e vëllezërve tanimë ishte tepër e vogël për 15 antarë të familjes. U bë afër një vit që dola nga burgu. Punë nuk kishte për mua askund. Ende jetoja tek vëllezërit në Prishtinë, të cilët tetë vite, sa qeshë në burg, u kujdesen shumë për mua e ma mbajtën familjen. Në pranverë të vitit 1988 bëra plan të largohem nga Kosova për të gjetur punë dikund në Kroaci apo në Slloveni. Babai dhe vëllezërit nuk më lejuan ta lëshoja familjen dhe Kosovën. Ishte fillimi i korrikut, kur një dashamir i familjes tonë R.B., djali i të cilit punonte në SPB-ën Krahinore, më njohtoi se së shpejti do të bëhën ca burgosje në Kosovë dhe emri im gjendet në listën e atyre që do të arrestohen. Ky element i ri që u krijua ato ditë, bëri që as babai dhe as vëllezërit më të mos kërkonin që ta shtyej largimin nga Kosova. Pas dy ditësh u largova pa e ditur askush, përpos familjes. E zgjodha Zagrebin si vendstrehim të përkohshëm. Askend nuk e njihja në Zagreb, por kur don të ndihmojë i Madhi Zot, nuk është vështirë për Te. Posa zbrita në stacionin e trenit, u ula pak të pushoi. Kalonin njerëzit afër meje

dhe askush s'e qante kokën për hallet e mia, sesi do të gjendem, ku do të flej, a do të gjejë punë dhe përkrahje nga shqiptarët e shumë që punonin në Zagreb. M'u afrua një burrë i përvuajtur, fytyra e të cilit tregonte mirësi, zgjuarësi dhe vuajtje. Të gjetja burrë i dheutl, më tha ai. Thuase, më kish njohur që sa vitel Pyetjet dhe përgjigjet nuk kishin të sosur. Eja, më tha, se po shkojmë sonte te unë. Bukë e kripë e zemër e çka ka dhënë Zoti. Banesa e tij u bë e imja, një muaj e më tepër. Heret, çdo mëngjes, shkoja në tregun ku shitej fuqia punëtore. Ndonjë ditë më printe fati dhe gjeja punë, kryesisht punë të rënda fizike, por ndodhte që nga një javë nuk gjeja punë fare. Dashamiri im, quhej Shaban Krasniqi, i lindur në Brezhnicë të Vu-shtrisë. Ky njeri m'i dinte hallet dhe më kishte strehuar në banesën e tij, edhe pse nuk kishte të drejtë të më strehojë. Sepse, ishte banesa (baraka) e ndërmarrjes ku punonte, e ku nuk lejohej fare edhe banimi im. Një ditë ky më njohtoi se duhet të lajmërohem në Drejtorinë e Ndërmarrjes Ndërtimore «Bosna», në lagjen e Jarunit, që të bëj kontratën për t'ia filluar punës. Punova më tepër se një vit në atë ndërmarrje, por të ardhurat e vogëla mujore nuk mjaftonin për ta mbajtur familjen time. Në muajin nëntor të vitit 1989 vendosa të largohem nga Zagrebi për në Evropën Përendimore.

DRITA: A kishë dhe arsye tjera kur vendose të dalësh në Perëndim?

Sh. Jashari: Arsyeja kryesore që dola në Perëndim ishte çështja ekonomike. Me punën që bëja në Zagreb nuk kisha mundësi t'iu siguroja familjes as kushtet elementare të ekzistencës. Vetëm qiraja e banesës për familje më kushtonte 50 marka, kurse të ardhurat mujore që i siguroja për një muaj ishin gjithsej 100 marka. Pasaportë nuk kisha. Meqë nuk kisha as të holla për ta siguruar një të falsifikuar, u detyrova ta kalojë kufirin jugosllavo-austriak këmbë, ilegalisht. I telefonova Sabri Novosellës, që jetonte në Malme të Suedisë dhe ia tregova hallin tim. Më premtoi se, nëse s'do të mundej vet për të dalur në Austri, atëherë doemos do ta dërgojë dikend që të më merr. Atë ditë që vendosa ta kaloj kufirin i

telefonova prapë Sabriut dhe ia tregova kohën kur do të mbërrijë në Gracë të Austrisë. Për shkaqe objektive nuk u takuam me dy shokë që kishin ardhur nga Zvicra në Gracë për të më marrur e përcjellur deri në Zvicër. Një natë bujtëm në një hotel të Vjenës me dy prizrenas, me të cilët e kaluam së bashku kufirin. Kishim mbetur në mes të rrugës, pa të holla. Kisha aq të holla sa për t'i bërë telefon Sabriut dhe për t'i treguar se ku gjendem. Pas nja dhjetë minutash erdhi Rustem Çufaj (nga rrethi i Deçanit) në stacionin hekurudhor Vestbahnhof të Vjenës për të na marrur në shtëpinë e tij. Na prit sikur të ishim miqtë e tij më të mirë. Katër ditë hëngrëm dhe pimë me të gjitha të mirat e Zotit. Ishte befasë e madhe për mua pritja që më bëri kjo familje. Në zemër të Evropës gjallëronte kaq mirë tradita e vjetër shqiptare e mikëpritjes. Kjo ma forcoi shpirtin dhe më çlodhi nga ajo rrugë shumë e rrezikshme. Pas bisedave të gjata me Rustemin e të vëllain e tij Hysenin, e kuptova se Shefki Oseku (i cili, disa muaj para meje ishte strehuar me tre fëmijët e tij, po në këtë familje) i kishte telefonuar Rustem e Hysen Çufajt, që të më strehojnë në shtëpinë e tyre, derisa të vinin shokët nga Zvicra. Për bujarinë e treguar me atë rast, familjes Çufaj përjetë i jam mirënjohës!

DRITA: Pas Vjenës ku vajte, dhe si e përjetove diasporën gjatë atyre ditëve të para?

Sh. Jashari: Pas pesë ditëve erdhën për të na marrur nga Zvicra Ymer Berisha dhe Januz Mustafa. Në mbremje iu afroam kufirit austriako-zvicëran afër Buksit. Pasi këta kufirin nuk e njihnin mirë, kërkuan ndihmë prej Shefqet Murtezit dhe Nuhiut, mbiemrin e të cilit nuk e di. Shefqeti na shoqëroi deri afër kufirit dhe na tregoi se kah duhet të kalojmë. Në vendin e caktuar na pritën me dy vetura shokët dhe atë natë bujtëm te

Ymer Berisha, së bashku me prizrenasin që e kisha bashku-dhëtarë që nga Maribori i Sllovenisë. Unë pushova edhe dy ditë te Ymeri, ndërsa prizrenasi shkoi te një shok i tij. Pas një pritjeje vëllazërore, më kaloi tërë lodhja psikike dhe fizike e grumbulluar nga brenga sesi do të përfundojë ky udhëtim i gjatë. Vuaja për faktin se u bëra shkatërtar i telasheve për shumë shokë dhe dashamirë.

Këtu nuk po i përmendi har-

xhimet e mëdha materiale e lodhjen, sepse ka pasur edhe rreziqe tjera shumë më serioze. Pas dy ditësh, me kërkesën time, Ymer Berisha së bashku me Januz Mustafën, më dërguan në Qendrën për Strehim në Krikingen. Prej atyhit më transferuan në një Qendër të Kantonit të Neushatellit. Nuk i vazhdova kurset e gjuhës frenge, sepse pas katër muajsh gjeta punë me ndihmën e një bashkëko-mbasi. Familja ime kishte nevojë të madhe për ndihmë materiale. Pas një viti, më erdh djalë i madh, i cili i kishte ikur ushtrisë jugosllave. Pastaj, më erdhën e tërë familja



SABRI NOVOSELLA

pa krye, në radhë të parë duhet ndryshuar mënyrën e organizimit tonë, si në Kosovë ashtu edhe në Viset tjera shqiptare, të cilat ende gjenden nën sundimin sllav. Por kjo vlenë edhe për diasporën shqiptare. Organizimi i shqiptarëve nëpër parti politike, është shkaku kryesor i dështimit tonë, sepse u çelën rrugët e përçarjeve partiake, krahinore, grupore dhe klanore. Historia nuk njeh ende një rast të vetëm që një popull i robëruar është çliruar pa një Qendër Komanduese, që e organizon dhe e udhëheq popullin për çlirim. Vendimet e Qendres në fjalë, do të ishin të obliguara për çdo pjesëtar të kombit të robëruar, përpos bashkëpuntorëve të okupatorit. Poqese, në kohën sa më të shkurtër subjektet tona politike nuk ndryshojnë punën e tyre, në rend të parë, për ta gjetur gjuhën e përbashkët, për të vepruar bashkarisht, për gjetjen e mënyrës për organizim të ri, me një Udhëheqje të Re, që ka autoritet dhe besim në masat e gjëra popullore, që është e zonja ta udhëheq popullin tonë për realizimin e aspiratave të tija, atëbotë, dështimi i kësaj politike, do t'i sjellë popullit tonë tragjedinë edhe më të madhe, pas asaj të okupimit të parë nga serbosllavët. Kam frikë se udhëheqja e Kosovës, me punën e saj shtatëvjeçare i ka sjellur aq shumë dëme çështjes sonë kombëtare (me politikën e saj »*prit gomarë sa të del barë*«), sa që është shumë vështirë që Lëvizja e jonë ta merë rrugën e mbarë, brenda një kohe të shkurtër. Vetëm organizimi i popullësisë në baza kombëtare, udhëhequr nga bijtë më besnikë, që kanë një përvojë të gjatë jetësore, e dije të gjithanshme për organizim, autoritet dhe besim të pakontestueshëm, me një strategji e taktikë të përpunuar mirë, do të mund ta shpiente Lëvizjen tonë përpara. Veç kështu do të kishim korrur suksese të njëpasnjëshme, si brenda territoreve tona etnike, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Nga një politikë e mençur, ku do të përdoren të gjitha mjetet për çlirim kombëtar, pa fije dyshimi se do të vijë deri te çlirimi dhe bashkimi kombëtar, që ka qenë dhe është qëllimi përfundimtar i Lëvizjes sonë Kombëtare, që nga Rilindja jonë Kombëtare e deri në ditët e sotme.

DRITA: Si e shihni gjendjen në Shqipëri pas ngjarjeve shkurtit dhe marsit të këtij viti?

Sh.Jashari: Tani, çdo njeri që di të mendojë me logjikë, e ka të qartë se shteti shqiptar u shkatërrua në bazë të një skenari të përgaditur mirë nga stalinistët shqiptarë dhe çerdhet e sigurimeve të huaja, që i kanë krijuar armiq të tanë shekullorë në Shqipëri, e në bashkëpunim me Qendrat e Vendosjes Ndërkombëtare. Për fatin tonë të zi, fara e mbjellur e bolshevizmit në trojet tona nga Popoviqët e Mugoshët, ka futur rrënjë të thella në trurin e krisur, në mendjen e marrë të një pjese të vogël të popullësisë shqiptare, që janë të verbuar nga dogmat komuniste. Disa nuk e kanë ende të qartë se ajo ideologji është mbjellur në trojet tona nga armiq të tanë, jo për të na ndihmuar, por për të na robëruar. Jo që të na çelin horizonte përparimi, por që në mendjet tona të krijojnë mjegullë dhe kaos, dhe të na verbërojnë, për të mos e bërë dallimin në mes territ dhe dritës, në mes të bardhës dhe të zezës, në mes rregullësisë dhe kaosit, në mes demokracisë dhe diktaturës, në mes të miqëve dhe armiqëve. Jam i bindur se Shqipëria edhe për një kohë bukur të gjatë, do të mbetet siç ishte gjatë regjimit komunist: e dobët ekonomikisht dhe ushtarakisht dhe pa autoritet ndërkombëtar. Poqese udhëheqjen e shtetit shqiptar dhe institucionet e tij nuk i drejtojnë atdhetarët e mirëfilltë, për të cilët Shqipëria dhe shteti i saj do t'ishin mbi çdo gjë tjetër, ne do të kemi një Shqipëri të pafuqishme, çfarë fatkeqësisht e patëm pas L D B-re. Derisa partitë politike shqiptare dhe krerët udhëheqës ta kuptojnë se Shteti dhe Shqipëria janë të shenjta, nuk pritet ndonjë e mirë për kombin tonë. Sot Shqipëria është futur në krizën më të thellë, që nga viti 1912. Ajo është e rrezikuar nga partiakët dhe karrieristët të sëmurë për pushtet, të lidhur me rrjetin e spiunazhit serbo-grekë, urdhërat e të cilëve po i kryejnë me përpikëri. Skenari ngeli pa u kryer në tërësi, në saje të atdhetarëve, që u organizuan për ta mbrojtur çdo pllëmbë të Shqipërisë si dhe në saje të armatosjes të Shqipërisë Veriore. Por, zhdukja e faktorit të shtetit shqiptar si faktor i rëndësishëm ballkanik si dhe desta-

ime e ngushtë, por kjo ndodhi pa dë-shirën time. Diasporën e kam përjetuar si burgun tim të tretë, menjë ndryshim, se këtu isha i burgosur i lirë, në të drejta për të lëvizur në tërë terri-torin e Zvicrës.

DRITA: Gjatë vitit 1990 ndodhën përmbyesje të mëdha në botë. Si e përjetuat Ju rënjen e komunizmit në Shqipëri?

Sh.Jashari: Kam qenë i verbër nga propoganda e PPSH-ës. Kam qenë i bindur se Shqipëria nuk do ta pësoi ashtu siç e pësuam shtetet e kampit socialist. Mendoja se edhe poqese ndërrohet sistemi, ai do të bëhet me hapa të matur dhe pa trazira e shkatërrime të mëdha. Mendoja se duhet lejuar formimi i partive politike, duke qenë i bindur se edhe me vota të lira PPSH-ja do ta fitojë pushtetin.

DRITA: A jeni anëtarësuar në ndonjë parti, nëse po, në cilën - nëse jo, pse jo?

Sh.Jashari: Ato ditë kur pata ardhur në Zvicër, kishin pas filluar parapërgaditjet për formimin e Degës së LDK-ës. Pas pak u formua Dega në Curih e më vonë, edhe Nëndegët. Në Kantonin e Neuchatelit ku jetoja, nuk kishte pasur kurfarë organizimi të shqiptarëve. Sikur të kishte qenë si duhet LPK-ja në Zvicër, aty e kam pasur vendin, por pasi ajo kishte qenë e përçarë në tri rryma, unë nuk u anëtarsova në asnjërën prej tyre. Pasi në Kanton nuk kishte pasur kurfarë organizimi, m'u duk e arsyeshme t'u ndihmoi ca aktivistëve për ta formuar Nëndegën e LDK-ës. U krijua Nëndega e LDK-ës dhe u hap një klasë për mësimin plotësues për nxënësit e paktë që atëherë ishin në qytetin ku unë jetoja. Unë u bëra mësues i asaj paraleleje të hapur kah fundi i vitit 1990. Në vitin shkollor 1991/92, u rrit numri i nxënësve. Ishte nevoja të hapën edhe klasë tjera. Sejdi Haziri, që ishte një mësues me përvojë të gjatë në arësim, e ngriti në një shkallë më të lartë cilësinë e mësimin plotësues duke më ndihmuar që nxënësit t'i mësojmë së bashku. Dy vite kam qenë anëtar i LDK-ës. Tash nuk jam i anëtarësuar në asnjë parti.

DRITA: Çka mendoni për kritikën e Demaçit e Kadaresë që ia drejtuan kohë më parë presidentit tonë, dr. Ibrahim Rugovës?

Sh.Jashari: Kritika e Demaçit dhe e Kadaresë, ka qenë e tëra me vend dhe tani është e qartë për të gjithë, përpos për ata që janë kokëzbrazur, për të cilët partia është mbi çdo gjë, pra edhe mbi interesa kombëtare.

DRITA: Si e shihni ju zgjidhjen e çështjes së Kosovës. A do t'a arrijmë t'i ikim luftës me serbët, apo kjo do të jetë e pashmangëshme?

Sh.Jashari: Kemi humbur aq shumë kohë të vlefshme duke bërë sehirë dhe duke dëgjuar pallavrat e celulës udhëheqëse të Kosovës, se gjëja faktori i jashtëm do të na zgjidhë çështjen tonë kombëtare. Udhëheqja e Kosovës me punën që ka bërë deri tani, e ka bërë të pamundshme të hyjmë në luftë me serbët dhe ta fitojmë atë. Tani është bërë tepër vonë, për ta filluar një luftë çlirimtare. Veçmas pas shkatërrimit të shtetit shqiptar nga socialkomunistët shqiptarë dhe Sigurimet e shteteve të huaja. Tani celulat udhëheqëse e Kosovës po bëjnë përgaditjet e duhura që ta marrin atë që bën rahmet t'ia jep regjimi i Millosheviqit, në saje të presioneve që atij po ia bëjnë Qendrat e Vendosijes Ndërkombëtare. Këto Qendra duan që shqiptarëve t'ua njohin të drejtat e pakicës kombëtare dhe, asgjë më tepër!

DRITA: Cili është opcioni yt për Kosovën pikërisht sot?

Sh.Jashari: Që nga viti 1992 Lëvizja jonë Kombëtare ka hyrë në rrugë pa krye. Ka dalur me shumë opsione, pa një Program Kombëtarë të përpunuar mirë, pa një strategji dhe taktikë që do t'ishte reale dhe e realizueshme, duke u mbështetur në radhë të parë në faktorin e brendshëm, e në radhë të dytë në atë ndërkombëtarë. Dështimi i politikës shtatëvjeçare është i qartë. Prandaj, duhet gjetur shkaqet e këtij dështimi. Tash, si edhe më parë, po i shohim gabimet individuale dhe kolektive, por kjo nuk është mjaftë për të ndryshuar gjendjen e mjerë në të cilën gjendemi. Për të dalur nga kjo rrugë

bilizimi i Shqipërisë, megjithatë është një fitore e madhe e armiqëve tanë shekullorë dhe aleatëve të tyre. Atyre nuk ju shkon për shtati që Shqipëria të jetë një shtet i fortë ekonomikisht dhe ushtarakisht dhe i stabilizuar politikisht. Forcimi i shtetit shqiptar do t'u sillte atyre pengesa të mëdha për t'i mbajtur trojet tona nën sundim. Mu për këtë edhe Qendrat e Vendosjes muarrën pjesë tërthorazi për shkatërrimin e shtetit shqiptar. Kjo u bë me qëllim që problemin e Kosovës ta mbyllin si një problem të pakicës kombëtare, për t'ia plotësuar kështu huret e Serbisë imperialiste.


DRITA: I mbushet shtatë vite në diasporë. A jeni të kënaqur me këtë organizim të diasporës, apo mendoni se duhet ndryshuar diçka?

SH.Jashari: Organizimi i diasporës shqiptare është anomalia më e madhe që mund të mendohet. Në vend se shqiptarët që janë të shpërndarë në të katër anët e botës, t'i bashkojnë të gjitha forcat intelektuale, morale dhe materiale, duke u bërë kështu një krah i fortë për Kosovën dhe Viset tjera shqiptare, që ende po rrënojnë nën zgjedhjen sllave dhe krah i fortë edhe për Shqipërinë Nënë - partiakët tanë e përçarë diasporën në baza ideologjike, krahinore, grupore dhe klanore, për ca interese të vogla partiake dhe individuale. Kjo tregon se vetëdija kombëtare është shumë e vogël në kreun udhëheqës të partive tona politike, prandaj, nuk duhet ushqyer iluzione se ato udhëheqësi do të jenë të zonja t'i arrijnë objektivat për të cilat betohen çdo ditë se është qëllimi i tyre

përfundimtar. Suksesi arrihet vetëm atëherë kur organizimi i diasporës shqiptare të bëhet në baza kombëtare, duke i formuar Bashkësitë Kombëtare, të cilat do të ishin Qendrat e vetme ku do të ndaheshin detyrat për t'u kryer, e jo sipas miqësive personale, por në bazë të aftësisë të çdo individi, për realizimin e objektivave që i cakton Qeveria e Kosovës. Në organizim është me rëndësi shumë të madhe të dihet saktësisht se kush duhet të jep urdhëra e kush t'i kryej ato me përpikëri dhe çdo individ të jetë përgjegjës për punën që ka marrur për ta kryer.

DRITA: Çka prisni nga zgjedhja e Demaçit kryetar i PPK-ës? A do t'ia arrijë ai që ta dinamizojë Lëvizjen tonë Kombëtare?

SH.Jashari: Demaçi, si dhe më parë, derisa nuk ishte i anëtarësuar në parti politike, na ka mësuar, na ka udhëzuar dhe na ka gortuar, por pa dobi. Mësimet dhe udhëzimet e tij nuk janë marrë në konsideratë fare nga



JUSUF GËRVALLA

strukturat udhëheqëse të Kosovës. Edhe tani, pasi u bë kryetar i PPK-ës, ai po mundohet ta ndërroi status-quon në Kosovë, por pa sukses. LDK-ja, nga frika se PPK-ja do të bëhet opozitë e fortë dhe, do t'i përzihet asaj në monopolin që e ka krijuar në të gjitha fushat e jetës së varfër politike kulturore e propagandistike, po i përdorë metodat e lejuara dhe të palejuara që ta pengojë PPK-ën dhe ta luftojë atë e udhëheqjen e saj, madje pa kurrfarë parimi. Prandaj, në këto kushte dhe rrethana, PPK-ja me në krye Demaçin, nuk do të mund ta bëjë ecjen e duhur përpara. PPK-ja pa

Drifta nr 16
1997

përkrahjen edhe të partive tjera politike shqiptare nuk do të jetë në gjendje ta dinamizojë Lëvizjen tonë Kombëtare, të cilën, siç dihet, e kanë paralizuar ata, për të cilët partia është mbi kombin e atdheun.

DRITA: Ju e lexoni revistën tonë DRITA. Çka ju pëlqen dhe çka nuk ju pëlqen në këtë revistë?

Sh.Jashari: Revista më pëlqen shumë. Ka një fizionomi origjinale që e dallon prej Revistave tona. Rubrika e dokumenteve është shumë e qëlluar. Vështrimi i Hajdin Abazit për asimilimin e fëmijëve tanë në diasporë më ka pëlqyer tepër. Poashtu edhe Shqiptar Oseku me shkrimet e tija në mbrojtjen e çështjes sonë kombëtare tek organizatat e ndryshme të Suedisë dhe në opinionin suedez. Interesante është dhe faqja e poezisë që botohet në të dy gjuhët: shqip-suedisht dhe anasjelltas. Kjo vlenë edhe për prozën *Hetimet* të Shefki Osekut. Në këtë prozë artistikisht po pasqyrohet periudha më e re të historisë sonë kombëtare, që padrejtësisht u la pas dore nga shkrimtarët, poetët dhe dramaturgët tanë të shumtë. Por, DRITA i ka edhe anët e dobëta. Në radhë të parë, duhet të jetë e përgaditur në një nivel më të lartë teknik, duke botuar në faqet e saja edhe piktura apo fotografi nga bukuritë e shumta të Viseve tona. Pastaj, kishte qenë mirë që të gjendet mundësia për ta shpërndarë në tërë Evropën, në Shqipëri, Kosovë dhe në Viset tjera shqiptare.

DRITA: Ju falemnderit për intervistën! Le të shpresojmë se ideali Juaj për lirinë e Kosovës dhe bashkimin e saj me Nënë Shqipëri do të realizohet për gjatë jetës Suaj!

Sh.Jashari: Dhashtë Zoti dhe ashtu u bëftë! Më lejoni që Redaksisë dhe bashkëpunorëve Tuaj t'iu uroj çdo të mirë. Urojmë që Revistën tuaj dhe tonën të na e bëni edhe më të pasur edhe më cilësore. Por, kurrë të varur nga ndonjë parti politike apo klan, i kujdo qoftë. DRITA jonë qoftë gjithmonë vetëm kombëtare!

-FUND-

7. 19